

5 minuta vlejnë sa një JETË



SQ

ÇFARË ËSHTË KONTROLLI MAMOGRAFIK?

Kontrolli mamografik ofron **zbulim të hershëm** të lezioneve të vogla, përpara se të mund të ndihen me prekje.

Prandaj mund të merren masa që tani, duke shtuar shanset e **trajtimeve efektive** më pak agresive për gratë dhe me mundësi më të mëdha për shërim.

Kontrolli është për të gjitha gratë që janë rezidente, me vendbanim dhe nën përkujdesje në Emilia-Romagna, të cilat janë të ftuara të bëjnë një mamogramë **çdo vit për moshat 45 deri 49 vjeç dhe çdo dy vjet për moshat 50 deri 74 vjeç.**

Një **mamogramë** është një grafi e gjirit dhe një test i **thjeshtë, falas dhe që zgjat vetëm pak minuta.**

PËRSE TË BËHENI PJESË E KONTROLLIT MAMOGRAFIK?

- Sepse duke u bërë pjesë e kontrolleve në Emilia-Romagna **reduktioni vdekshmërinë nga kanceri i gjirit deri në 56%.**
- Sepse ofron **cilësinë dhe saktësinë më të lartë** në diagnostikim, si dhe mamografia vlerësohet veçmas nga dy radiologë të ndryshëm.
- Sepse është **gjithçka falas dhe e organizuar**, nga mamografia deri në diagnostikim dhe trajtim.

KONTROLLI IDENTIFIKON KANCERIN E GJIRIT



45-49 VJEÇ
1 NË 300 GRA TË TESTUARA

50-69 VJEÇ
1 NË 164 GRA TË TESTUARA

70-74 VJEÇ
1 NË 95 GRA TË TESTUARA

- 56%
vdekshmëri


KONTROLLI MAMOGRAFIK
NË EMILIA ROMAGNA

ËSHTË EKZAMINIMI I RREZIKSHËM OSE I DHIMBSHËM?

Për ta kryer ekzaminimin saktë, gjoksi duhet të shtypet. Disa gra ndiejnë pak siklet ose dhimbje të lehtë, por që zgjat vetëm pak sekonda.


Doza e rrezeve-X që përdoren është shumë e ulët dhe mundëson imazhe me cilësi shumë të lartë, me ekspozim minimal.

ÇFARË NDODH KUR MAMOGRAMA ËSHTË NEGATIVE?



Është vendosur që të ftohen gratë e moshave 45 deri 49 çdo vit, pasi dendësia e gjirit është shumë e shpeshtë në këto moshë dhe e kufizon mundësinë e zbulimit të ndryshimeve të dyshimta me anë të mamografisë.

ÇFARË NDODH KUR MAMOGRAMA ËSHTË E DYSHIMTË?



CILAT JANË KUFIZIMET E KONTROLLIT?


Ndodh rrallë (rreth 1 në 1500 gra), por mund të ndodhë që pas një mamograme negative dhe para kontrollit të radhës, të zhvillohet kanceri: është e rëndësishme që t'i kushtohet gjithmonë vëmendje çdo ndryshimi në gjiri dhe, nëse vëreni të tilla, kontaktoni mjekun tuaj ose qendrën e kontrollit.

Mamografia mund të zbulojë tumore shumë të vogla, por rreth 15-30% të kancerave nuk zbulohen gjatë kontrollit. Mund të ndodhë gjithashtu që me mamografi të zbulohen tumore me rritje të ngadaltë (rreth 10%), që nuk do t'i shkaktonin probleme shëndetësore një gruaje ("mbidiagnostikim").

Paraqituni për vizitën: pesë minuta, një shqetësim më pak.

PO KËRKONI MË SHUMË INFORMACION?

Vizitoni faqen



Mund të na telefononi gjithashtu në



nga e hëna më të premte, ora 8:30 - 18:00
E shtunë: 8:30 - 13:00